



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 15 qershor 2015**

**Numri i lëndës: 2014-41**

**Liridona Mustafa - Sadiku**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 qershor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 12 shtator 2014.

### **II. FAKTET**

2. Ankuesja është e veja e z. Faton Sadiku, i cili ishte punëtor i EULEX-it që nga viti 2009 e deri në kohën e vdekjes.

3. Faktet, siç janë parashtruar nga ankuesja mund të përmbliohen si më poshtë.
4. Z. Sadiku ishte sëmurë më 12 shkurt 2014 dhe kishte kërkuar ndihmë mjekësore në Njësinë e Mjekësisë së EULEX-it. Ai ishte diagnostikuar me grip dhe iu ishte dhënë këshillë mjekësore.
5. Më 17 shkurt 2014, kur gjendja e tij nuk ishte përmirësuar, z. Sadiku përsëri kishte shkuar në Njësinë Mjekësore të EULEX-it. Atij iu ishin përshkruar barna për grip.
6. Më 20 shkurt 2014, ai prapë kishte vizituar Njësinë e Mjekësisë. Duke parë se gjendja e tij ishte përkeqësuar, mjekët e EULEX-it kishin vendosur ta dërgonin atë në një spital në Shkup, IRJM. Ankuesja nuk ishte konsultuar lidhur me këtë vendim.
7. Gjatë qëndrimit të bashkëshortit të saj në spital në Shkup, ankuesja ishte përpjekur të merrte informacione të hollësishme në lidhje me gjendjen e tij nga stafi mjekësor atje dhe nga EULEX-i, por pa sukses.
8. Z. Sadiku ka vdekur në spitalin e Shkupit më 16 mars 2014.
9. Pas vdekjes së tij, ankuesja ka kërkuar nga Njësia e Mjekësisë së EULEX-it që t'i jepej dosja mjekësore të bashkëshortit të saj. Më 19 gusht 2014, shefja e Njësisë së Mjekësisë së EULEX-it ka informuar atë se EULEX-i ndjek rregulla të rrepta për mbrojtjen e të dhënave dhe ka kërkuar nga ajo që të ofroj dëshmi se ajo ishte pasardhëse ligjore ose përfaqësuese ligjore e pasardhësve të të ndjerit. Ajo gjithashtu ka informuar ankuesen se EULEX-i nuk e ka marrë dosjen mjekësore të bashkëshortit të saj nga spitali, pasi atje ai ishte pacient privat.

### III. ANKESAT

10. Ankuesja pohon se EULEX-i ka dështuar të ofroj kujdesin e duhur mjekësor për burrin e saj dhe si pasojë ka shkelur të drejtën e tij për jetë, të garantuar me nenin 2 për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Për më tepër, ajo ka pohuar se EULEX-i ka dështuar të hetoj rrethanat e vdekjes së z. Sadiku, që ka rezultuar me shkeljen e nenit 3 të Konventës (ndalimi i torturës dhe i dënimeve ose trajtimeve të tjera çnjerëzore apo poshtëruese).
11. Ajo më tej pohon se dështimi i EULEX-it që ta informoj atë rreth shkakut të vdekjes së bashkëshortit të saj përbën trajtim çnjerëzor, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

#### IV. LIGJI

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
14. Paneli thekson se, në përputhje me praktikën e zhvilluar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të afërmit e ngushtë të një personi, vdekja e të cilit dyshohet se përfshinë përgjegjësinë e autoriteteve, mund që vetë të pretendojnë të jenë viktimë jo të drejtpërdrejta të shkeljes së pretenduar të nenit 2 të Konventës (shih *Velikova kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 41488/98, 18 maj 2005; *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, GjDNj 2001-III; *Lambert dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 46043/14, 5 qershor 2015, §§ 89-90; *Mezhiyeva kundër Rusisë*, nr. 44297/06, 16 prill 2015, § 55), Prandaj ankuesja e ka statusin e viktimës jo të drejtpërdrejtë lidhur me vdekjen e bashkëshortit të saj. Për më tepër, ajo gjithashtu mund të pretendoj të jenë viktimë në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të saja.
15. Paneli së pari do të shqyrtojë ankesën për aq sa ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të bashkëshortit të ankueses.
16. Në bazë të nenit 25, paragrafi 1, të rregullores së vet të punës, Paneli nuk ka juridiksion *ratione personae* në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të personelit të EULEX-it në Kosovë. E njëjta dispozitë kufizon juridiksionin e Panelit, *ratione materiae*, në këto aktivitete të Misionit që hyjnë në kuadër të mandatit të tij ekzekutiv. Për të dyja këto arsye, Paneli nuk është kompetent të merret me ankesën për aq sa ajo ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të të drejtave të z. Sadiku. Megjithatë, Paneli e kupton shqetësimin dhe dhembjen që vdekja e tij duhet t'i ketë shkaktuar gruas dhe të afërmeve të tij.
17. Sa i përket shkeljes së dyshuar të të drejtave të ankueses, Paneli vëren se ankesa e ankueses ka të bëjë me neglizhencën e dyshuar nga ana e stafit mjekësor të EULEX-it.
18. Paneli përsërit se sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me

shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave. Paneli konsideron se veprimet apo mosveprimet e personelit mjekësor të punësuar nga EULEX-i, detyra e të cilëve është që të ofrojnë ndihmë mjekësore për personelin, nuk mund të thuhet se hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Si rezultat, duke shprehur keqardhje për vuajtjet e ankueses, Paneli konsideron se kjo ankesë është jashtë juridiksionit të vet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë juridiksionit të tij në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese